

KONTRATË PËR SHITJEN E PJESEVE TE KAPITALIT

Sot me datë 16/08/2021 ,(gjashtëmbëdhjetë gusht dy mijë e njëzetë e një) në Tiranë, shtetasit e mëposhtëm u ulën dhe redaktuan këtë kontratë shitje kuotash.

PALET NE KONTRATE

1- Huda Senol, atesia Osman, i datëlindjes 03.03.1971, lindur në Turqi dhe banues në Turqi , Afyonkarahisar , Lagjia Kasimpasha, Rruga Gazligoz, Vila 111/A madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me pashaporte me nr. U24055763.

Dhe

2- Metehan Suoglu , atesia Hikmet, i datëlindjes 09.01.2000, lindur në Turqi dhe banues në Turqi ,Izmir, Rruga Karaklidene, Lagjia Karaklidene , Vila nr. 21 madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me pashaporte me nr. U24008551 .

te dyja palet me aftesi te plote per te vepruar, me vullnet te lire, duke ju permbajtur dispozitave te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, pranojne te lidhin dhe ne fakt lidhin kete Kontrate per Shitjen e Pjesëve sipas kushteve te meposhtme.

Kushtet paraprake

Shitesi eshte pronar i 1 kuote me vlere nominale 5000 Leke qe perfaqeson 50% (Pesedhjete perqind) te kapitalit themeltar te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, te quajtur **Matchless Water.**, me seli në TIRANE Njesia Bashkiake nr.6, Yzberisht, Rr. Bulevardi Kashar, Pallatet Fratari nr.2

Pala shitesë deklaron se kuotat e shoqerise **Matchless Water** jane plotesisht te lira nga cdo lloji barre e sekuestroje apo pengu.

Pala shitesë deklaron se ka marre prej pales blerese çmimin e shitjes per 5000 lekë të 1 kuote që perfaqëson 50% të kapitalit te shoqërisë si më sipër dhe pagesa

parashikohet në nenin 2 ,pika 2.2.

Bleresi deshiron te bleje dhe Shitesi deshiron te shese 50% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë me vlere 5000 Lekë të zotëruar nga Shitësi, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme;

Bleresi ka analizuar, verifikuar dhe miratuar gjendjen pasurore, financiare dhe kontabile të Shoqërisë në momentin e lidhjes së kësaj kontrate.

Meqë ekzistojnë këto kushte paraprake, palët bien dakort për sa me poshte vijon:

Neni 1 - Kushtet Paraprake

Kushtet paraprake te siperpermendura jane pjese perberese e kesaj Kontrate.

Neni 2 - Blerja e pjeseve te kapitalit

2.1. Shitesi merr persiper t'i shese dhe transferoje Bleresit, dhe Bleresi merr persiper te bleje, 50% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar te Shoqërisë të zoteruar nga Shitësi, tërësisht të lira nga çfarëdolloj detyrimi ne favor të të tretëve, dhe me një cmim te barabarte me vlerën e tyre nominale 5000 Lekë.

2.2. Pagimi i çmimit u be me para në dorë nga ana e Bleresit ne vlere 5000 Lekë, në momentin e firmosjes së kontratës.

Pronësia i kalon palës blerëse në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 3 - Detyrime dhe garanci

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe ne çfaredolloj momenti tjetër te metejshem pas lidhjes se saj, Shitesi do t'i garantoje Bleresit, prane selise se Shoqërisë, akses ne origjinalet e librave kontabel te Shoqërisë dhe cdo dokument tjetër, prone ose sende qe aktualisht jane ne pronesi te Shoqërisë, ose qe duhet me pas te behen te Shoqërisë.

Neni 4 - Korrespondenca

4.1. Te gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera ndermjet paleve duhet te behen me shkrim dhe te dorezohen prane selise se Shoqërisë, dhe prane selise se Bleresit.

4.2. Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera do të dërgohen me ane të letres rekomande ose me faks.

4.3. Çdo informacion, kërkesë ose njoftim do të jetë i vlefshëm vetëm nëse ekzistojnë kushtet e mëposhtme: a) nëse është dërguar me faks, në momentin në të cilin është marrë faksi; b) nëse është dërguar me leter rekomande, në datën e dorëzimit të marrësi që do të vërtetohet me fletën e kthimit.

Neni 5 - Shpenzime dhe taksa

Shpenzimet legale dhe kontabile, ashtu si edhe çfarëdo shpenzimi tjetër që lidhet me këtë kontratë, si edhe shpenzimet për transaksione të përfshira në to, do të jenë në ngarkim të palës që i mbulon. Në çdo rast, do të jenë në ngarkim të Blerësit të taksat, taksat e pullave dhe shpenzimet notoriale për Lidhjen e kësaj kontrate.

Neni 6 - Trashegimia dhe cedimi


Kjo kontratë do të detyrojë palët dhe do të jetë e vlefshme midis tyre, ashtu edhe për trashëgimtarët e tyre. Në çdo rast, asnjëra nga palët nuk mundet të kalojë të tretëve kontratën pa miratimin me shkrim të palës tjetër.

Neni 7 - Përbajtja e kontratës dhe ndryshimet

Kjo kontratë përfshin tërësisht marrëdhëniet midis palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme që janë të lidhura me këtë objekt. Ndryshime të mundshme ose kufizimet e kësaj kontrate mund të bëhen vetëm me shkrim, të nënshkruara nga të gjitha palët dhe t'i bashkëngjiten asaj.

Neni 8 - Origjinalet

Kjo kontratë hartohet në 4 (kater) origjinale, në gjuhën shqipe, të gjitha të



nenshkruara nga palet ne daten16/08/2021..

Neni 9 - Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Palet angazhohen te zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreveshje qe lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kesaj Kontrate. Nese nje zgjidhje e tille nuk eshte e mundur, mosmarreveshja do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor TIRANE.

Neni 10 - E drejta e zbatueshme

Kjo kontrate dhe te drejtat e detyrimet e paleve do te disiplinohen e ushtrohen ne baze te se drejtes shqiptare.

Neni 11 - Vlefshmeria

Kjo kontrate behet e vlefshme me nenshkrimin e kesaj kontrate nga palet.

Kjo kontrate nenshkruhet nga te dyja palet ne Tirane, me date 16/08/2021.

* * *

Palët pasi lexojnë aktin e mësipërm dhe e gjejnë atë konform vullnetit të tyre të lirë , e nënshkruajnë atë në prezencën e tyre.

Shitesi:

Metehan Suoglu



Bleresi:

Huda Senol

